



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 11.03.2021
Dokument parlamentar

RAPORT

MBI SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS NR. 11981, DATË 26.02.2021 “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 15/2021 “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 59/2014 “PËR KARRIERËN USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”.

• **HYRJE**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, në zbatim të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi në mbledhjen e datës 11.03.2021, Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 11981, datë 26.02.2021 “Për kthimin e ligjit nr. 15/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Për shqyrtimin i pretendimeve të ngritura në Dekretin e Presidentit për kthimin e ligjit për rishqyrtim, i pranishëm në komision ishte z.Petro Koçi, Zv. Ministër i Mbrojtjes.

Gjithashtu për të mbrojtur argumentat e kthimit të ligjit për rishqyrtim, morën pjesë edhe përfaqësues të Presidentit të Republikës.

• **BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT TË DEKRETIT**

Baza Ligjore mbi të cilën Komisioni për Sigurinë Kombëtare, shqyrton Dekretin e Presidentit është:

➤ ***Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila në nenin 85 të saj përcakton se:***

Neni 85

- 1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.*
- 2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë*

➤ **Rregullorja e Kuvendit, e cila në nenin 86 të saj përcakton se:**

Neni 86

Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji

1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht.

2. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës dhe brenda 8 javëve nga data e fillimit të shqyrtimi paraqet raportin e tij. Ky raport përmban mendimin e komisionit dhe, sipas rastit, edhe propozime për nene të veçanta të ligjit.

Arsyet e kthimit për rishqyrtim të ligjit nr. 15/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

• **ARGUMENTATE PËRMBLEDHURA TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

1. Ligji nr. 15/2021 nuk është konsultuar paraprakisht me vetë ushtarakët, dhe as me Presidentin e Republikës, si Komandanti i Përgjithshëm i FA. Publikimi i nismës në RENJK për marrjen e komenteve, mund të konsiderohet si përmbushje e detyrimit ligjor për konsultim, vetëm formalisht dhe këtë e tregon dhe fakti që nuk ka pasur asnjë koment
2. Neni 6, i ligjit nr. 15/2021, që ndryshon pikën 1, të nenit 15 të ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në FARSH”, i ndryshuar, përbën një ndryshim, i cili do të ketë impakt negativ lidhur me drejtimin strategjik dhe operacional të Forcave të Armatosura, pasi synohet të ulet niveli i arsimit të kërkuar për t’u përfshirë në FA dhe duke ulur nivelin e arsimit të kërkuar, cenohet direkt niveli i përgatitjes së trupës; karriera ushtarake, pasi ushtari për t’u titulluar nënoficer duhet të ketë arsimin parauniversitar. Presidenti i RSH gjatë arsytimit të tij, vlerëson gjithashtu se mungesa e aplikimeve për rekrutim lidhet ngushtë me trajtimin financiar të ushtarakëve të FARSH.
3. Ndryshimi i bërë në nenin 20, duke hequr nga ligji kriteret që kërkohen për arsimimin dhe kualifikimin për përparim në gradë dhe lënien e përcaktimit të tyre vetëm në dorë të ministrit të Mbrojtjes, ka impakt direkt në karrierën ushtarake dhe për pasojë, vënë këtë karrierë nën ndikimin direkt të ministrit të Mbrojtjes.

Për pasojë, ky ndryshim shkel edhe parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe bie ndesh me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 64, datë 26.09.2015.

4. Neni 10 i ligjit nr. 15/2021, bën ndryshime në nenin 21, të ligjit nr. 59/2014, ndryshime këto që rrezikojnë të çojnë në cenim të karrierës ushtarake dhe piramidës së drejtimit në Forcat e Armatosura. Mospërcaktimi në ligj i specialiteteve, por delegimi i tyre për përcaktim me akt nënligjor, lë hapësira që shërbime të caktuara, në periudha të ndryshme kohore të konsiderohen apo klasifikohen si “specialitete”. Gjendur në këto kushte dhe përballë kësaj situatë të krijuar, nuk mund që për mbylljen e mangësive të momentit, të ndërhyhet në ligj pa analizuar më parë shkaqet që kanë sjellë këtë situatë, që në thelb lidhet me trajtimin e ushtarakut, apo problematika që kanë të bëjnë me ecurinë në gradë apo emërimet jo transparente.
5. Ndryshimet e parashikuara në nenin 15, i ligjit nr. 15/2021, e vendosin ushtarakun në një pozitë aspak të favorshme, cenojnë ecurinë në karrierën ushtarake në mënyrën më të rëndë të mundshme, duke i bërë ushtarakët të lëvizshëm në funksione që nuk përputhen me gradën që mbajnë (qoftë dhe përkohësisht), sipas vullnetit të eprorëve.

• **ARGUMENTET LIGJORE KUNDËR DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

Gjatë shqyrtimit të Dekretit të Presidentit të Republikës Zv.Ministri i Mbrojtjes Zoti Koçi ftoi anëtarët e komisionit të votojnë kundër dekretit duke sjell kundërargumentat si më poshtë:

Në lidhje me argumentin se: Ligji nr. 15/2021 nuk është konsultuar paraprakisht me vetë ushtarakët, dhe as me Presidentin e Republikës, si Komandanti i Përgjithshëm i FA. Publikimi i nismës në RENJK për marrjen e komenteve, mund të konsiderohet si përmbushje e detyrimit ligjor për konsultim, vetëm formalisht dhe këtë e tregon dhe fakti që nuk ka pasur asnjë koment

Në lidhje me procesin e konsultimit publik të ligjit nr. 15/2021, sqarojmë se konsultimi publik për ligjin ka nisur më datë 25.3.2019, me dërgimin e draftit fillestar të hartuar të tij, i cili është hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të ministrit të Mbrojtjes dhe në përbërje të të cilit, në rolin e anëtarëve kanë qenë përfaqësues të të gjitha strukturave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, (Shtabi i Përgjithshëm i FA, Komandat e Forcave, Komanda Mbështetëse, (ish) Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes etj.), të cilët përbëjnë dhe grupin kryesor të interesit sa i përket kësaj nisme ligjore.

Në vijim, informojmë se grupi i punës, i ngritur me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, ka ftuar në mbledhjet e tij përfaqësues të Drejtorisë së Personelit të Shtabit të Përgjithshëm

të Forcave të Armatosura, Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe të Qendrës së Personel Rekrutimit, me qëllim dhënien e komenteve dhe sugjerimeve përkatëse, të cilat u mbajtën shënim nga sekretari teknik dhe pasi u vlerësuan nga GP, u vendos nëse do të përfshiheshin ose jo në përmbajtjen e ligjit. Krahas sugjerimeve nga strukturat e brendshme, në mbledhjet e grupit të punës janë marrë në konsideratë edhe propozimet e bëra nga ekipi këshillues amerikan “Defence Governance and Management Team”. Gjithashtu, drafti fillestar është dërguar në strukturat e SHPFA në formë shkresore dhe elektronike, më datë 25.3.2019.

Gjithashtu, pas marrjes së mendimeve nga strukturat përgjegjëse të lartpërmendura, është vijuar me publikimin e draftit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, më datë 29.6.2020 dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes. Konsultimi publik është mbyllur më datë 30.9.2020, 30 ditë pas publikimit të draftit në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes.

Si përfundim, me qëllim lehtësimin e dhënies së komenteve/sugjerimeve nga çdo i interesuar, në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, në rubrikën e dedikuar për konsultimin publik, është vënë në dispozicion adresa elektronike konsultim.publik@mod.gov.al, në të cilën çdo palë e interesuar mund të dërgonte të gjitha komentet apo sugjerimet në lidhje me përmbajtjen e ligjit.

Për sa më sipër, rezulton se procesi i konsultimit të ligjit nr. 15/2021 është në përputhje të plotë me vendimin nr. 64/2015 të Gjykatës Kushtetuese dhe me detyrimet e legjislacionit në fuqi për konsultimin publik.

Në lidhje me argumentin se: Neni 6, i ligjit nr. 15/2021, që ndryshon pikën 1, të nenit 15 të ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në FARSH”, i ndryshuar, përbën një ndryshim, i cili do të ketë impakt negativ lidhur me drejtimin strategjik dhe operacional të Forcave të Armatosura, pasi synohet të ulet niveli i arsimit të kërkuar për t’u përfshirë në FA dhe duke ulur nivelin e arsimit të kërkuar, cenohet direkt niveli i përgatitjes së trupës; karriera ushtarake, pasi ushtari për t’u titulluar nënoficer duhet të ketë arsimin parauniversitar. Presidenti i RSH gjatë arsytimit të tij, vlerëson gjithashtu se mungesa e aplikimeve për rekrutim lidhet ngushtë me trajtimin financiar të ushtarakëve të FARSH.

Në lidhje me parashikimin e nenit 6 të ligjit nr. 15/2021, sqarojmë se ky përcaktim kurrsesi nuk synon cedimin nga kërkesat për nivelin arsimor të domosdoshëm dhe rritjen e cilësisë së Forcave të Armatosura. Rekrutimi i ushtarëve/detarëve aktivë me arsim 9-vjeçar, do të bëhet në raste të kufizuara, përjashtimore dhe kur diktohet nga rrethana të caktuara, si vendndodhja, rëndësia e repartit ushtarak, apo kryerja e detyrave specifike, jo komplekse, të cilat nuk kanë nevojë për personel me trajnim apo kualifikim të avancuar.

Në vijim, sjellim në vëmendje gjithashtu, se në asnjë moment ligjvënësi nuk kushtëzon rekrutimin e ushtarëve/detarëve aktivë vetëm me arsim 9-vjeçar. Sikundër u përmend më sipër, rekrutime të tilla do të jenë të kufizuara dhe të diktuar nga rrethana të caktuara dhe

kursesi nuk kufizohet apo mohohet e drejta për aplikim si ushtar/detar aktiv i FARSH, personave të cilët disponojnë nivel arsimor më të lartë se ai 9-vjeçar dhe dëshirojnë të përparojnë në karrierë në FARSH.

Shqetësimi i Presidentit të RSH sa i përket trajtimin financiar të ushtarakëve të FARSH edhe pse konsiderohet i drejtë, nuk mund të jetë objekt i ligjit, i cili rregullon karrierën ushtarake, por është objekt i akteve nënligjore që rregullojnë këtë fushë. Gjithsesi, theksojmë faktin se Qeveria shqiptare nëpërmjet Këshillit të Ministrave, shfaq dhe ka shfaqur kurdoherë vullnetin e mirë për të përmirësuar trajtimin financiar të ushtarakëve, nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave, të cilat i kanë akorduar ushtarakëve të FARSH rritje page, apo trajtim/kompensim ushqimor të drejtë.

Në lidhje me argumentin se :Ndryshimi i bërë në nenin 20, duke hequr nga ligji kriteret që kërkohen për arsimimin dhe kualifikimin për përparim në gradë dhe lënien e përcaktimit të tyre vetëm në dorë të ministrit të Mbrojtjes, ka impakt direkt në karrierën ushtarake dhe për pasojë, vënë këtë karrierë nën ndikimin direkt të ministrit të Mbrojtjes. Për pasojë, ky ndryshim shkel edhe parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe bie ndesh me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 64, datë 26.09.2015.

Në lidhje me parashikimin e nenit 9 të ligjit nr. 15/2021, bëjmë me dije se me qëllim ofrimin e shërbimeve e përgatitjes bashkëkohore të trupës, procesi i arsimimit/kualifikimit për ushtarakët e FARSH është në ndryshim e përmirësim të vazhdueshëm. Me dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, si dhe nëpërmjet procesit të arsimimit/kualifikimit të ushtarakëve të FA, në bazë të marrëveshjeve bilaterale dhe në kuadër të NATO-s, në institucionet arsimore të vendeve aleate të Republikës së Shqipërisë, parashikimet e nenit 20 të ligjit aktual nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, janë tepër të ngurta e të kushtëzuara dhe si të tilla nuk janë në koherencë të zhvillimeve aktuale të FARSH.

Për sa më lartpërmendur, me qëllim përshtatjen sipas nevojave aktuale arsimore dhe të kualifikimit është i nevojshëm parashikimi se kriteret e arsimimit e të kualifikimit, përcaktohen në politikën e arsimimit të Forcave të Armatosura, të miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes e me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Për më tepër, sjellim në vëmendje se një dokument i tillë, i miratuar nga ministri i Mbrojtjes është detyrim i parashikuar në germën “nj”, të pikës 2, të nenit 13 të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në lidhje me argumentin se : Neni 10 i ligjit nr. 15/2021, bën ndryshime në nenin 21, të ligjit nr. 59/2014, ndryshime këto që rrezikojnë të çojnë në cenim të karrierës ushtarake dhe piramidës së drejtimit në Forcat e Armatosura. Mospërcaktimi në ligj i specialiteteve, por delegimi i tyre për përcaktim me akt nënligjor, lë hapësira

që shërbime të caktuara, në periudha të ndryshme kohore të konsiderohen apo klasifikohen si “specialitete”. Gjendur në këto kushte dhe përballë kësaj situatë të krijuar, nuk mund që për mbylljen e mangësive të momentit, të ndërhyhet në ligj pa analizuar më parë shkaqet që kanë sjellë këtë situatë, që në thelb lidhet me trajtimin e ushtarakut, apo problematika që kanë të bëjnë me ecurinë në gradë apo emërimet jo transparente.

Sa i përket pikës 2, të nenit 10 të ligjit nr. 15/2021, sjellim në vëmendje se veprimtaria e Forcave të Armatosura shfaq dinamika të reja, të cilat shoqërohen me ndryshime strukturore apo nevojën për afrimin e specialiteteve të ndryshme. Mospërcaktimi në ligj i specialiteteve, nuk përkon dhe nuk ka asnjë lidhje me mbylljen e mangësive të momentit dhe as me trajtimin e ushtarakut, apo problematika që kanë të bëjnë me ecurinë në gradë apo emërimet jo transparente, sikundër citohet në arsyetimin e Presidentit, por përkundrazi kanë në thelb trajtimin e diferencuar të një kategorie ushtarakësh, të cilët kanë specialitete të veçanta dhe që mund të kontribuojnë në mënyrë afatgjate me dijet e tyre në fusha të veçanta të veprimtarisë së FARSH. Përshtatja me dinamikat e veprimtarisë së FARSH, të cilat për hir të së vërtetës janë në ndryshim të vazhdueshëm, nëpërmjet ngurtësisë që shfaq përcaktimi i specialiteteve në ligj, do të ishte i vonuar dhe jo koherent.

Në lidhje me argumentin se :Ndryshimet e parashikuara në nenin 15, i ligjit nr. 15/2021, e vendosin ushtarakun në një pozitë aspak të favorshme, cenojnë ecurinë në karrierën ushtarake në mënyrën më të rëndë të mundshme, duke i bërë ushtarakët të lëvizshëm në funksione që nuk përputhen me gradën që mbajnë (qoftë dhe përkohësisht), sipas vullnetit të eprorëve.

Në lidhje me nenin 15 të ligjit nr. 15/2021, sqarojmë se emërimi në një funksion më të ulët organik i ushtarakut të FARSH, bëhet për një periudhë deri në 1 (një) vit dhe se për çdo periudhë përtej këtij viti, është i nevojshëm pëlqimi me shkrim, paraparak i ushtarakut. Ky parashikim ka për qëllim plotësimin e përkohshëm të pozicioneve organike, të cilat kryejnë detyra specifike dhe nuk mund të qëndrojnë vakante dhe është gjithashtu, në përputhje me doktrinën ushtarake, në të cilën parashikohet se ushtaraku kryen shërbimin e tij kudo ku paraqitet e nevojshme.

Gjithashtu, bëjmë me dije se në asnjë moment ushtaraku i FARSH nuk vendoset në një pozitë jo të favorshme, pasi trajtimi financiar, si dhe përparimi në karrierën ushtarake do të kryhen në bazë të akteve ligjore e nënligjore referuar gradës që ushtaraku mban për momentin dhe jo pozicionit të tij të përkohshëm organik.

• PËRFUNDIME

Sa më sipër, Komisioni për Sigurinë Kombëtare, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, votoi pro rrëzimit të Dekretit Presidentit të Republikës nr. 11981, datë 26.02.2021 “Për kthimin e ligjit nr. 15/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin

nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe kalimin e tij seancës plenare në përputhje me nenin 85/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Relator

Antoneta DHIMA

Kryetar

Ermonela (Felaj) VALIKAJ